



**VENDIM**

**Nr. 52 Datë 02.05.2012**

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË HEC  
“ULËZ - SHKOPËT” SH.A NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE  
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, nenit 13 pika 1 gërma “ç” dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f” dhe 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.05.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni finaciuar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht. (mungon **neni 9, pika 3, gërma “a”** (vërtetim për shyerjen e tatim taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore).
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”) janë paraqitur dhe plotësuar ne menyre korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
Bordi i Komisionerëve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**